Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

15.06.2020, Prishtinë,
Ref:27.04.2020\969-2020

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Aferdita Kryeziut kundër portalit të lajmeve Telegrafi

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 10 qershor 2020, shqyrtoi ankesën e Aferdita Kryeziut kundër portalit të lajmeve Telegrafi lidhur me artikullin me titull: "Përplasje të ashpra mes Memli Krasniqit dhe Imer Mushkolajt", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me shkrimin e publikuar në portal me titull "Përplasje të ashpra mes Memli Krasniqit dhe Imer Mushkolajt", dhe pretendimin se shkrimi përbënë shkelje të Kreut III (Nxitja dhe gjuha e urrejtjes) të Kodit të mediave të shkruara.

Lajmi është shkruar në media të shkruar dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të shkrimit dhe shqyrtimit të ankesës, KMShK vendos se ankesa nuk miratohet.

Media ka publikuar një shkrim me një video nga Televizioni Dukagjini. Shkrimi përfol videon dhe pjesët e cituara nga debati, dhe nuk kanë të bëjnë me nxitjen e gjuhës së urrejtjes ashtu siç përshkruhet në Kodin e Mediave

KMShK vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës